Instituti i Statistikave
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017

info@instat.gov.al
www.instat.gov.al
Tel: +355 4 2222 411
Faks: +355 4 2222 411

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave

# Tregtia e jashtme e mallrave

## Mars 2020

**Tiranë, më 17 Prill 2020:** Në Mars 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 18 mld lekë, duke u ulur me 36,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 29,0 %, në krahasim me Shkurt 2020. Importet e mallrave arritën vlerën 42 mld lekë, duke u ulur me 25,4 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 19,3 %, në krahasim me Shkurt 2020. Deficiti tregtar i këtij muaji është 24 mld lekë, duke u ulur me 14,9 %, krahasuar me Mars 2019 dhe me 10,2 %, në krahasim me Shkurt 2020.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në tremujorin e parë 2020 eksportet e mallrave arritën vlerën 66 mld lekë, duke u ulur me 9,0 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 135 mld lekë, duke u ulur me 8,5 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 70 mld lekë, duke u ulur me 8,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2019.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:**

Rënia vjetore e eksporteve prej 36,2 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: “Tekstile dhe këpucë” me -18,4 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -8,9 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -6,6 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Produkte kimike dhe plastike” me 0,04 pikë përqindje.

**Për publikim17/04/2020**

*Vijon*

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Mars 2020




Eksportet, gjatë këtij tremujori janë ulur me -9,0 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: "Tekstile dhe këpucë" me -7,3 pikë përqindje, "Materiale ndërtimi dhe metale" me -3,1 pikë përqindje, "Prodhime druri dhe letre" me -0,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: "Makineri, paisje dhe pjesë këmbimi" me +1,1 pikë përqindje,

"Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me +0,4 pikë përqindje, "Produkte kimike dhe plastike" me +0,2 pikë përqindje.

**Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:**

Rënia vjetore e importeve prej 25,4 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: "Makineri, paisje dhe pjesë këmbimi" me -7,4 pikë përqindje, "Materiale ndërtimi dhe metale" me -5,2 pikë përqindje, "Tekstile dhe këpucë" me -4,8 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar pozitivisht grupi: "Ushqim, pije, duhan" me +0,7 pikë përqindje.

**Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve,Mars2020**




Si tremujor, importet janë ulur me 8,5 %, krahasuar me tremujorin e parë 2019. Grupet që kanë ndikuar neativisht në uljen vjetore të importeve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -3,4 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -2,4 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,9 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve ka ndikuar pozitivisht grupi: “Ushqim, pije, duhan” me +0,6 pikë përqindje.

**Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere**

Në muajin Mars 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Mars 2019 janë: Spanja (25,7 %), Gjermania (9,2 %),dhe Hollanda (20,8 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë:Italia (-48,5 %), Kosova (-43,1 %) dhe Greqia (-24,6 %).

Gjatë këtij tremujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Spanja (55,4 %),Gjermania (18,5 %), dhe Greqia (3,0 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-18,0 %), Kosova (-17,3 %) dhe Maqedonia e Veriut (-9,5 %).

Në muajin Mars 2020, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Mars 2019 janë: Rusia (+102,4 %), Zvicra (+28,2 %), dhe Polonia (+4,3 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-29,8 %), Greqia (-24,1 %) dhe Turqia (-18,6 %).

Gjatë këtij tremujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Greqia (0,3 %),Turqia (4,8 %) dhe Gjermania (0,6 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Italia (-13,0 %), Kina (-16,6 %) dhe Serbia (-7,8 %).

## Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Mars 2020




Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 64,4%, të gjithë tregtisë. Në Mars 2020, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,9 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 59,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (30,3 %), Greqia (7,7 %), Gjermania (7,4 %) dhe Turqia (5,9 %).

Shkëmbimet tregtare, për tremujorin e parë 2020, me vendet e BE zënë 64,3 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Mars 2020, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 79,5% të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 57,0 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (32,1 %), Greqia (7,7%), Gjermania (7,0 %) dhe Turqia (6,5%).

## Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

| Vitet | Muajt | Eksporte (mld lekë) | Ndryshimi Vjetor (%) | Importe (mld lekë) | Ndryshimi Vjetor (%) | Bilanci Tregtar (mld lekë) | Mbulimi (%) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2000 | | 37 | -23,5 | 157 | -1,5 | -120 | 23,6 |
| 2001 | | 44 | 19,1 | 190 | 21,0 | -146 | 23,2 |
| 2002 | | 47 | 7,7 | 210 | 10,6 | -163 | 22,6 |
| 2003 | | 54 | 14,7 | 226 | 7,4 | -172 | 24,1 |
| 2004 | | 62 | 14,0 | 236 | 4,5 | -174 | 26,3 |
| 2005 | | 66 | 6,0 | 262 | 11,1 | -196 | 25,1 |
| 2006 | | 77 | 17,6 | 299 | 14,1 | -222 | 25,9 |
| 2007 | | 97 | 25,5 | 376 | 25,8 | -279 | 25,8 |
| 2008 | | 113 | 15,8 | 440 | 16,9 | -327 | 25,6 |
| 2009 | | 105 | -7,2 | 429 | -2,5 | -324 | 24,4 |
| 2010 | | 162 | 54,6 | 478 | 11,4 | -316 | 33,8 |
| 2011 | | 197 | 21,9 | 544 | 13,9 | -347 | 36,2 |
| 2012 | | 213 | 8,2 | 528 | -2,9 | -315 | 40,3 |
| 2013 | | 246 | 15,7 | 517 | -2,1 | -271 | 47,6 |
| 2014 | | 256 | 3,8 | 552 | 6,7 | -296 | 46,3 |
| 2015 | | 243 | -4,9 | 545 | -1,4 | -302 | 44,7 |
| 2016 | | 243 | 0,1 | 579 | 6,4 | -336 | 42,0 |
| 2017 | | 273 | 12,1 | 626 | 8,1 | -353 | 43,6 |
| 2018 | | 310 | 13,7 | 641 | 2,4 | -331 | 48,4 |
| 2019 | | 299 | -3,8 | 649 | 1,2 | -350 | 46,0 |
| | | | | | | | |
| 2018 | 01 - 18 | 24 | 24,5 | 45 | 27,5 | -21 | 52,5 |
| | 02 - 18 | 24 | 18,8 | 46 | 4,4 | -22 | 52,0 |
| | 03- 18 | 27 | 14,6 | 55 | 2,5 | -28 | 49,0 |
| | Janar- Mars 18 | 75 | 18,9 | 146 | 9,7 | -72 | 51,0 |
| | | | | | | | |
| 2019 | 01 - 19 | 22 | -7,3 | 42 | -6,2 | -20 | 51,9 |
| | 02 - 19 | 23 | -5,3 | 50 | 8,5 | -27 | 45,4 |
| | 03 - 19 | 28 | 2,7 | 56 | 1,4 | -28 | 49,6 |
| | Janar- Mars 19 | 72 | -3,0 | 148 | 1,3 | -76 | 48,8 |
| | | | | | | | |
| 2020 | 01 - 20 | 23 | 5,3 | 42 | -0,4 | -19 | 54,9 |
| | 02 - 20 | 25 | 10,6 | 52 | 3,9 | -27 | 48,3 |
| | 03 - 20 | 18 | -36,2 | 42 | -25,4 | -24 | 42,5 |
| | Janar - Mars 20 | 66 | -9,0 | 135 | -8,5 | -70 | 48,6 |

## Tab, 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

| | Eksporte | | | | Importe | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mars 2019 | Mars 2020 | Jan, - Mar, 2019 | Jan, - Mar, 2020 | Mars 2019 | Mars 2020 | Jan, - Mar, 2019 | Jan, - Mar, 2020 |
| **Vendet e BE-së** | **20.709** | **13.473** | **57.040** | **52.280** | **34.896** | **24.859** | **88.079** | **77.183** |
| Austri | 163 | 143 | 676 | 437 | 891 | 478 | 1.747 | 1.162 |
| Gjermani | 1.108 | 1.210 | 3.372 | 3.997 | 3.744 | 3.168 | 10.014 | 10.074 |
| Greqi | 1.038 | 783 | 2.911 | 2.998 | 5.030 | 3.816 | 12.501 | 12.538 |
| Itali | 13.875 | 7.145 | 37.902 | 31.076 | 15.514 | 10.887 | 38.528 | 33.502 |
| Spanjë | 1.042 | 1.310 | 4.223 | 6.562 | 931 | 490 | 2.056 | 2.261 |
| Kroaci | 111 | 142 | 257 | 500 | 554 | 304 | 1.407 | 1.098 |
| Të tjera të BE-së | 3.371 | 2.739 | 7.701 | 6.709 | 8.232 | 5.716 | 21.827 | 16.550 |
| Mbretëri e Bashkuar | 59 | 72 | 164 | 202 | 463 | 424 | 1.218 | 1.170 |
| Kinë | 613 | 204 | 1.354 | 1.216 | 4.987 | 2.860 | 13.413 | 11.184 |
| Kosovë | 2.785 | 1.585 | 5.837 | 4.829 | 644 | 459 | 1.453 | 1.506 |
| Maqedonia e Veriut | 866 | 554 | 1.817 | 1.644 | 777 | 558 | 1.909 | 1.842 |
| Rusi | 37 | - | 58 | 6 | 842 | 1.704 | 2.775 | 4.631 |
| SHBA | 514 | 278 | 1.166 | 739 | 1.105 | 683 | 2.698 | 2.351 |
| Turqi | 127 | 160 | 636 | 601 | 4.113 | 3.349 | 11.874 | 12.447 |
| Ukrainë | 41 | 80 | 77 | 147 | 125 | 279 | 601 | 935 |
| Zvicër | 172 | 20 | 259 | 189 | 803 | 1.030 | 4.474 | 3.302 |
| Të tjera | 1.896 | 1.332 | 3.872 | 3.924 | 7.297 | 5.586 | 19.483 | 18.905 |
| **Gjithsej** | **27.820** | **17.757** | **72.280** | **65.777** | **56.053** | **41.791** | **147.979** | **135.458** |

## Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

| Grup-mallrat | Eksporte | | | | Importe | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Mars 2019 | Mars 2020 | Jan, - Mar, 2019 | Jan, - Mar, 2020 | Mars 2019 | Mars 2020 | Jan, - Mar,2019 | Jan, - Mar, 2020 |
| **Gjithsej** | **27.820** | **17.757** | **72.280** | **65.777** | **56.053** | **41.791** | **147.979** | **135.458** |
| Ushqime. pije. duhan | 2.867 | 2.661 | 7.098 | 6.989 | 9.437 | 9.821 | 24.734 | 25.620 |
| Minerale. lëndë djegëse. en.el. | 4.411 | 2.575 | 10.916 | 11.201 | 6.102 | 4.082 | 19.583 | 14.561 |
| Produkte kimike dhe plastike | 608 | 619 | 1.598 | 1.769 | 7.908 | 6.636 | 19.944 | 19.270 |
| Lëkurë dhe artikujt prej tyre | 180 | 168 | 616 | 639 | 1.598 | 1.072 | 4.109 | 3.395 |
| Prodhime druri dhe letre | 833 | 619 | 2.334 | 2.159 | 2.068 | 1.568 | 5.430 | 5.205 |
| Tekstile dhe këpucë | 10.775 | 5.670 | 30.980 | 25.692 | 7.582 | 4.869 | 20.300 | 17.530 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 4.852 | 2.389 | 11.306 | 9.097 | 7.025 | 4.125 | 17.316 | 17.100 |
| Makineri. pajisje dhe pj. këmb. | 2.530 | 2.512 | 5.350 | 6.177 | 12.226 | 8.054 | 31.355 | 27.843 |
| Të tjera | 763 | 543 | 2.082 | 2.052 | 2.109 | 1.564 | 5.208 | 4.935 |

*Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT:* http://www.instat.gov.al/

### Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

| | Itali | | Spanjë | | Kosovë | | Gjermani | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2019 | 2020 | 2019 | 2020 | 2019 | 2020 | 2019 | 2020 |
| **Gjithsej** | **37.902** | **31.076** | **4.223** | **6.562** | **5.837** | **4.829** | **3.372** | **3.997** |
| Ushqim. pije duhan | 2.131 | 1.964 | 369 | 250 | 615 | 776 | 326 | 336 |
| Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike | 1.777 | 357 | 3.216 | 5.834 | 1.596 | 554 | 377 | 211 |
| Produkte kimike dhe plastike | 479 | 506 | 10 | 61 | 371 | 484 | 18 | 12 |
| Lëkurë dhe artikuj prej lëkure | 511 | 522 | 35 | 45 | 1 | 2 | 4 | 2 |
| Prodhime druri dhe letre | 1.691 | 1.380 | 1 | 1 | 184 | 183 | 30 | 81 |
| Tekstile dhe këpucë | 24.272 | 19.480 | 498 | 311 | 19 | 23 | 1.716 | 2.303 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 3.622 | 3.107 | 91 | 45 | 2.558 | 2.202 | 361 | 356 |
| Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi | 2.438 | 2.899 | 2 | 5 | 145 | 193 | 379 | 469 |
| Të tjera | 982 | 860 | 1 | 10 | 349 | 411 | 161 | 226 |

### Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

| | Itali | | Greqi | | Turqi | | Kinë | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2019 | 2020 | 2019 | 2020 | 2019 | 2020 | 2019 | 2020 |
| **Gjithsej** | **38.528** | **33.502** | **12.501** | **12.538** | **11.874** | **12.447** | **13.413** | **11.184** |
| Ushqim. pije duhan | 4.470 | 4.674 | 3.485 | 3.906 | 1.330 | 1.353 | 231 | 149 |
| Minerale. lëndë djegëse. enerergji elektrike | 1.803 | 848 | 2.826 | 2.532 | 168 | 327 | 1 | 3 |
| Produkte kimike dhe plastike | 4.239 | 3.921 | 1.813 | 1.820 | 1.637 | 1.745 | 1.237 | 1.137 |
| Lëkurë dhe artikuj prej lëkure | 3.336 | 2.785 | 9 | 8 | 67 | 65 | 213 | 144 |
| Prodhime druri dhe letre | 1.546 | 1.508 | 689 | 769 | 670 | 642 | 188 | 209 |
| Tekstile dhe këpucë | 9.847 | 8.067 | 921 | 862 | 3.969 | 3.587 | 2.468 | 2.153 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 4.826 | 3.964 | 1.810 | 1.776 | 2.267 | 2.575 | 1.906 | 1.594 |
| Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi | 7.261 | 6.667 | 575 | 555 | 1.391 | 1.766 | 5.982 | 4.713 |
| Të tjera | 1.200 | 1.067 | 373 | 310 | 375 | 388 | 1.188 | 1.083 |

# Metodologjia

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë. të vendosura nën regjimin doganor. në përpunimin pasiv ose të rieksportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues. pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë. të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë. për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues.pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri ne kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifat doganore.

http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë. Gjermani. Francë. Itali. Luksemburg. Holandë.Danimarkë. Irlandë. Greqi. Spanjë. Portugali. Austri. Finlandë. Suedi. Qipro. Çeki. Estoni. Hungari. Letoni. Lituani. Maltë. Poloni. Sllovaki. Slloveni. Bullgari. Rumani. Kroaci.

**Shpjegimi i simboleve**

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri